



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Pml.nr.156/2024

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit F. Xh., për shkak se në bashkëkryerje ka kryer veprën penale keqtrajtimi gjatë detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.45/2020, të 29.08.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1388/2022, të 14.11.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 20.03.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit F. Xh., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.45/2020, të 29.08.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1388/2022, të 14.11.2023.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.45/2020, të datës 29.08.2022, të dënuarit F. Xh., A. O., A. Q. dhe J. R. janë shpallur fajtor se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK. Të dënuarit F. Xh. i është caktuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) € e cila gjobë do të paguhet në këste mujore në afat prej 6 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim.

Të dënuarit A. O. i është caktuar dënimi me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) € e cila gjobë do të paguhet në këste mujore në afat prej 6 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim.

Të dënuarit A. Q. i ka caktuar dënimin me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) € e cila gjobë do të paguhet në këste mujore në afat prej 6 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim.

Të dënuarit J. R. i ka caktuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh i cili dënim me pëlqimin e të dënuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqind) € e cila gjobë do të paguhet në këste mujore në afat prej 6 muajve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën gjykata do t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 € të gjobës me një ditë burgim.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Janë obliguar të dënuarit që secili veç e veç të paguajnë për shpenzimet e paushallit gjyqësor shumë prej nga 30 € si dhe për fondin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 €. Konform nenit 363 të KPP ndaj të dënuarve F. Xh., A. O., A. Q. dhe J. R. është refuzuar akuza për shkak se në bashkëkryerje kishin me kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1. nr.1388/22 të datës 14.11.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e të dënuarve F. Xh. dhe J. R., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, kurse e ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A. O. dhe ankesën e të akuzuarit A. Q. , e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës parë dhe në pajtim me nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1,3 të KPP, të akuzuarit A. O. dhe A. Q. janë liruar nga akuza, me të cilën në bashkëkryerje do të kryenin veprën penale keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 198 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit F. Xh. avokati Limon Musa, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, që ta aprovon si të bazuar kërkesën, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.90/2024, të 13.03.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435 paragrafi 1 lidhur me nenin 436 paragrafi 1 të KPPK-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse në aktgjykime nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare, se arsyet e paraqitura janë të paqarta dhe kundërthënëse, gjykata nuk ka dhënë arsye se në cilat prova dhe fakte e ka bazuar aktgjykimin e kundërshtuar, edhe ato pakë arse që janë dhënë të njëjtat janë në kundërshtim jo vetëm me dispozitivin e këtij aktgjykimi por edhe me arsyetimin. Në pjesën tjetër të kërkesës mbrojtësi i të dënuarit i referohet vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit mbi dënimin i cili i është shqiptuar të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtojë dhe analizojë pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as nuk është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit.

Në radhë të parë, është e nevojshme që të theksohet se aktgjykimet e kundërshtuara me kërkesë, në të gjitha pjesët e tyre janë të kuptueshëm dhe nuk janë kundërthënëse në asnjë pikë. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë është i kuptueshëm, i qartë dhe konkret si dhe në përputhshmëri të plotë me arsyetimin, përpilimi i të cilëve është bërë konform dispozitave të nenit 369 paragrafi 4 lidhur me nenin 364 të KPP-së, ku janë përfshirë gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën i dënuari është shpall fajtor.

Në arsyetimet e këtyre aktgjykimeve janë paraqitur mjaftueshëm arsye për të gjitha çështjet e rëndësishme që i referohen, si aspekteve faktike, ashtu edhe aspekteve juridike të këtij rasti. Në këtë drejtim, në arsyetimet e këtyre aktgjykimeve janë paraqitur arsye të qarta dhe të plota se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruara të vërtetuara, është vlerësuar saktësia e provave kundërthënëse, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykatat e lartcekura janë bazuar me rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të dënuarit F. Xh., të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet e mbrojtësit të dënuarit në pjesën e kërkesës që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të njëjtat nuk janë shqyrtuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, sepse bazuar në dispozita të nenit 432 paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë theksuar të gjitha rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Përndryshe, duhet theksuar faktin se

nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimeve të shqiptuara, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkuluar kompetencat ligjore, kështu që pretendimet e mbrojtësit në këtë drejtim nuk qëndrojnë.

Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385, paragrafi 5. të KPP, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet vetëm në rastet kur gjykata i ka tejkuluar kompetencat ligjore me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlidhej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.156/2024, më 20.03.2024

Procesmbajtës,  
Bujar Balaj

Kryetar i kolegjit,  
Afrim Shala